

VENDIM
Nr. 1, datë 21.1.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	anëtar i “	“
Sokol Berberi	anëtar i “	“
Vitore Tusha	anëtar i “	“
Fatmir Hoxha	anëtar i “	“
Besnik Imeraj	anëtar i “	“
Fatos Lulo	anëtar i “	“
Gani Dizdari	anëtar i “	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 22.9.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 41/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Kume Dapi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, shoqëria përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k., Tiranë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Gani Dizdari, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuases, e cila kërko i pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k., Tiranë, si dhe pasi diskuto i çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja, bazuar në vendimin nr. 142, datë 19.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është trashëgimtare ligjore e Hysen Dapit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 6022, datë 7.7.2011, la në fuqi vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të KKP-së të qarkut Tiranë, i cili kishte vendosur që trashëgimtarët ligjorë të Hysen Dapit, ku përfshihet edhe kërkuësja, të njihen pronarë të një sipërfaqeje prej 100 dynmësh, e ndodhur te kthesa e Kamzës, në fshatin Mëzes, komuna Kashar, qarku Tiranë, prej së cilës iu kthye fizikisht sipërfaqja prej 91247 m², ndërsa për sipërfaqen prej 8753 m² atyre u ishte njohur e drejta e kompensimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4102, datë 29.3.2012, lëshoi urdhrin për ekzekutimin e vendimit nr. 6022, datë 7.7.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Shoqëria përmbarimore private “Hoti Bailiff Service” filloi ekzekutimin e detyrueshëm, duke i kërkuar regjistruesit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë, regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, objekt i vendimit gjyqësor nr. 6022, datë 7.7.2011 të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Regjistruesi i ZVRPP-së Tiranë, bazuar në nenet 25/a, 37 dhe 45 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, hartoi projekturdrhin nr. 1784, datë 8.6.2012, “Për refuzimin e regjistrimit të kësaj pasurie me arsyetimin se dokumentet e paraqitura për regjistrim nga kërkuuesja krijonin mbivendosje me pasurinë e regjistruar më parë në favor të Bashkisë të Tiranës, në favor të shtetit apo edhe me pasuritë e pronarëve të tjerë privatë.”. Ky projekturdhër, me të njëjtat arsye, u la në fuqi nga urdhri nr. 523, datë 19.6.2012, i Kryeregjistruesit të ZQRPP-së.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8736, datë 24.7.2013, vendosi: “Anulimin e urdhrit nr. 523, datë 19.6.2012, të Kryeregjistruesit të ZQRPP-së; detyrimin e ZVRPP-së Tiranë që të regjistrojë titullin ekzekutiv, vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të ZRKKP-së të qarkut Tiranë, duke kryer shënimet përkatëse për kalimin e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të Hysen Dapit për sipërfaqen e truallit prej 91247 m².”

6. Prej aktit të ekspertimit, i hartuar nga eksperti topograf i thirrur nga gjykata, ka rezultuar se planvendosja e pronës që u është njohur dhe kthyer trashëgimtarëve ligjorë të Hysen Dapit me vendimin nr. 136, datë 26.5.2008, të ZRKKP-së të qarkut Tiranë, bazuar në këqyrjen dhe matjet në terren, krijon mbivendosje me pasurinë nr. 68/55 vol 18, faqe 159, të ndodhur në ZK 2679, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe me pasurinë nr. 98, vol 4, faqe 148, ZK 2679, në pronësi të shtetit, ndërsa nuk krijon mbivendosje me pozicionin gjeografik faktik të pasurive të tjera të personave privatë të cituar në urdhrin nr. 523, datë 19.6.2012 të Kryeregjistruesit të ZQRPP-së.

7. Gjykata Administrative Tiranë, me vendimin nr. 1167, datë 1.4.2014, la në fuqi vendimin nr. 8736, datë 24.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Mbi kërkesën e kërkueses, shoqëria përmbarimore private “Strati Bailiff’s Service” filloi ekzekutimin e detyrueshëm të vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përmbarim të këtij ekzekutimi të detyrueshëm përmbaruesi gjyqësor lëshoi urdhrin nr. 2884. prot, datë 14.5.2014, me anë të të cilit urdhëronte ZVRPP-në Tiranë që të regjistronte titullin ekzekutiv, vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të ZRKKP-së të qarkut Tiranë, duke kryer shënimet përkatëse për kalimin e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të Hysen Dapit për sipërfaqen e truallit prej 91247 m².

9. Kërkuuesja është vënë në dijeni nga shoqëria përmbarimore se pala debitore, ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresën e datës 7.8.2014, ka njoftuar këtë shoqëri se në përgjigje të aplikimit të saj ka kryer vetëm veprimin e inskriptimit të urdhrit të përmbaruesit gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e pasqyruar atë në seksionin E të kartelës së pasurisë me nr. 68/55, vol 18, f. 159, të ndodhur në ZK 2679, regjistruar në pronësi të Bashkisë Tiranë. Kësaj shkrese i është bashkëngjitur kopja e kartës së kësaj pasurie, ku në seksionin E të saj rezulton se është bërë shënimi i urdhrit të përmbaruesit gjyqësor nr. 6173 prot., datë 14.5.2014 të shoqërisë përmbarimore private “Strati Bailiff’s Service”.

10. Pas këtij veprimi, kërkuuesja, në datën 20.8.2014, i është drejtuar me kërkesë përmbaruesit gjyqësor dhe ZQRPP-së, për dijeni edhe ZVRPP Tiranë, duke kërkuar marrjen prej përmbaruesit gjyqësor të të gjitha masave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të detyruar regjistruesit e ZVRPP-së Tiranë të ekzekutojnë në mënyrë të rregullt dhe të plotë vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe ushtrimin nga ana e Kryeregjistruesit të kontrollit mbi veprimtarinë e regjistruesit të ZVRPP-së Tiranë për zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me ekzekutimin e rregullt dhe të plotë të këtij vendimi gjyqësor.

11. Në përgjigje të kërkesës, Kryeregjistruesi i ZQRPP-së, me shkresën nr. 4724/1, datë 26.9.2014, është shprehur se bazuar në dispozitat ligjore për këtë kërkesë, kërkuuesja duhej t’i drejtohej ZVRPP-së Tiranë dhe se për të marrë informacion nga kjo zyrë duhej të paguheshin tarifat përkatëse, ndërkohë që kërkuuesja, në cilësinë e kreditorit, kishte paguar tarifën për ekzekutimin e detyrueshëm të regjistrimit të vendimit gjyqësor.

12. Përmbaruesi gjyqësor, me shkresat nr. 246, datë 12.1.2015 dhe nr. 1305, datë 30.1.2015,

paralajmëroi ZVRPP-në Tiranë dhe ZQRPP-në për vendosjen e gjobës dhe me vendimin nr. 2519, datë 19.2.2015 ka vendosur të gjobisë për moskryerjen e veprimit të caktuar, regjistruesen e ZVRPP-së Tiranë.

13. Regjistruesa e ZVRPP-së Tiranë, me shkresën nr. 7945, datë 9.3.2015, ka njoftuar si përfaqësuesin e kërkuases, ashtu edhe shoqërinë përmbartimore private “Strati Bailiff’s Service”, se në datën 9.3.2015 e ka regjistruar vendimin nr. 1167, datë 1.4.2014 të Gjykatës Administrative Tiranë në seksionin “Përshkrimi i veçantë” dhe në seksionin E të kartelës së pasurisë me nr. 68/55, vol. 18, f. 159, të ndodhur në ZK 2679, në pronësi të Bashkisë Tiranë, me regjistrim të tipit “Kufizim” deri në zgjidhjen e çështjes me themel, me objekt fshirjen e regjistrimeve të kryera dhe pretendimin e palëve nga organet kompetente. Kësaj shkrese i është bashkëngjitur kopja e kartës së kësaj pasurie, ku si në seksionin “Përshkrimi i veçantë”, ashtu edhe në seksionin E të saj rezulton se është bërë regjistrimi i vendimit nr. 1167, datë 1.4.2014, të Gjykatës Administrative Tiranë.

14. Gjithashtu, pala debitorë, në datën 25.2.2015 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt padie “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore për gjobitjen për moskryerje të veprimit të caktuar” në emër të titullares së institucionit. Me vendimin nr. 2762, datë 20.5.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.”*

II

15. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5679, datë 17.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm.

16. **Subjekti i interesuar**, Zyra Përmbartimore Tiranë, me shkresën nr. 877 prot., datë 30.6.2015, paraqiti dosjen përmbartimore, ku pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e tij në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

17. Kërkuesja pretendon se pala debitorë, ZVRPP-ja, refuzon të ekzekutojë vendimin gjyqësor të formës së prerë duke vazhduar të pengojë me veprimet e saj procesin e regjistrimit të pronës në emër të kërkuases.

18. Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata) ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqësisë të drejtë. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për

të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të çështjes duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (shih vendimet nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese.)

20. Gjykata e vlerëson çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë (24.7.2013) deri në ushtrimin e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë më shumë se 2-vjeçare. Një periudhë e tillë për regjistrimin e një vendimi gjyqësor konsiderohet nga Gjykata si një afat i paarsyeshëm dhe i gjatë.

i) Kompleksiteti i çështjes

21. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt regjistrimin e një vendimi gjyqësor nga ZVRPP-ja, duke bërë kështu veprimin e fundit të kalimit të pronësisë dhe njohjes trashëgimtare të kërkuarës mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Argumenti i paraqitur nga ZVRPP-ja lidhet me ekzistencën, sipas saj, të një regjistrimi të mëparshëm në kohë dhe nëse do të regjistrohej edhe prona e kërkuarës, atëherë do të kishte një mbivendosje midis pronave të dy subjekteve. Sipas ZVRPP-së, një veprim i tillë nuk mund të kryhet prej saj pa shmangur mbivendosjen, gjë e cila duhet të bëhet vetëm nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

22. Pavarësisht këtij argumenti, Gjykata vlerëson se çështja nuk paraqet kompleksitet ligjor, duke qenë se zgjidhja e problemit faktik që ekziston në regjistrimin e pronës nga ana e ZVRPP-së nuk e bën çështjen komplekse në atë shkallë saqë të përbëjë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se veprimi që duhet të kryhet nga pala debitore nuk ka kosto financiare, që të mund të pengojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

23. Gjykata çmon se nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuarës dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Sjellja e kërkuarës

24. Kohëzgjatja për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuarës, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

25. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuarja nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo ka ndjekur rigorozisht të gjitha veprimet e nevojshme juridike për të finalizuar të drejtën e saj të fituar gjyqësish, pra regjistrimin e faktit të qenies trashëgimtare e ligjshme dhe si e tillë pronare e ligjshme e objekteve të përcaktuara në vendim gjyqësor.

26. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuarja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të saj për rivendosjen e së drejtës së cenuar dhe duke shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

iii) Sjellja e autoriteteve

27. Për të përcaktuar sjelljen e autoriteteve në këtë çështje është e nevojshme të vlerësohet nëse shoqëria përmbartimore dhe ZVRPP-ja kanë marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga gjykata.

28. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej ineffektiv dhe i

pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimi nr. 7, datë 27.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata konstaton se përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe ai i ka shfrytëzuar ato. Shoqëria përmbarimore ka kryer të gjitha komunikimet e nevojshme, me qëllim vënien në dijeni dhe detyrimin e palës debitore për të zbatuar vendimin gjyqësor, deri në vendosjen e gjobës për mosekzekutim të vendimit gjyqësor. Me qëllim përmbushjen e këtij ekzekutimi të detyrueshëm, përmbaruesi gjyqësor lëshoi urdhrin nr. 2884 prot., datë 14.5.2014, me anë të të cilit urdhëronte ZVRPP-në Tiranë që të regjistronte titullin ekzekutiv, vendimin nr. 136, datë 26.5.2008 të ZRPP-së të qarkut Tiranë, duke kryer shënimet përkatëse për kalimin e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të Hysen Dapit, për sipërfaqen e truallit prej 91247 m². Përmbaruesi gjyqësor, me shkresat nr. 246, datë 12.1.2015 dhe nr. 1305, datë 30.1.2015, paralajmëroi ZVRPP-në Tiranë dhe ZQRPP-në për vendosjen e gjobës dhe me vendimin nr. 2519, datë 19.2.2015, ka vendosur gjobitjen për moskryerjen e veprimit të caktuar nga ana e regjistrueses së ZVRPP-së Tiranë.

32. Nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se nga shoqëria përmbarimore janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, përfshi edhe vendosjen e gjobës, por ato kanë rezultuar të pasuksesshme.

33. Gjykata mori në vlerësim, gjithashtu, edhe veprimet e palës debitore, ZVRPP-së Tiranë, e cila ka refuzuar vazhdimisht të regjistrojë një vendim gjyqësor të formës së prerë. ZVRPP-ja ka parashtruar si argument për mosregjistrimin e vendimit gjyqësor se ka mbivendosje të pronave midis dy ose më shumë subjekteve dhe se kjo situatë, sipas saj, duhet zgjidhur nga kërkuesja në rrugë gjyqësore.

34. Gjykata konstaton se duke filluar nga data 24.7.2013, kur është nxjerrë urdhri i ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pasur një korrespondencë të gjatë midis kërkueses, shoqërisë përmbarimore dhe palës debitore. Gjatë gjithë kësaj kohe nga ana e palës debitore nuk është marrë asnjë masë konkrete për të regjistruar pronën. Shënimi i vendosur nga ana e ZRPP-së si pronë e regjistruar me kufizim, nuk është zgjidhje e këtij problemi dhe as ekzekutim i vendimit gjyqësor, pasi kërkuesja aktualisht nuk mund të pajiset me një certifikatë të rregullt pronësie. Gjykata çmon se një proces tjetër gjyqësor ose administrativ do të cenonte edhe më tej kërkuesen në realizimin e së drejtës së saj për të qenë pronare dhe për të ushtruar efektivisht të drejtën e pronës. Për këtë arsye, i takon palës debitore të gjejë mjete të tjera për të ekzekutuar vendimin gjyqësor. Është detyrim i debitorit që në çështjen konkrete të gjejë mundësitë e duhura për të regjistruar pronën në emër të kërkueses sipas vendimit gjyqësor dhe jo të paraqesë pengesa apo arsye për të mos e regjistruar pronën në emër të kërkueses.

35. Megjithatë, pavarësisht detyrimit që ka pala debitore për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, Gjykata e sheh me vend të theksojë se në rastet kur regjistrimi i pronës në regjistrin e pasurive të paluajtshme ndesh në vështirësi ose është i pamundur për shkak të mbivendosjes së dy ose më shumë pronave, kjo situatë kërkon një zgjidhje, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë sistemin e

regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Gjykata vëren se bazuar në nenin 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (i ndryshuar), ky institucion, mes të tjerash, drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë, si dhe kryen drejtimin metodik të shërbimeve dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Bazuar në nenin 13/c të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, institucion i varësisë së Ministrisë të Drejtësisë është edhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Duke qenë se është detyrë funksionale e organit epror të monitorojë dhe të kontrollojë veprimtarinë e organeve vartëse, duke marrë masat përkatëse që funksionimi i këtyre të fundit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, mosushtimi i këtyre tagrave, për të siguruar që të drejtat e shtetasve të garantohen ose për të korrigjuar gabimet e organit vartës në bazë të ndërhyrjes vertikale, do të ravijëzohet në një përgjegjësi të organit epror. Për këtë arsye, Gjykata e gjen me vend të theksojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes së këtij organi për të siguruar shmangien e situatave të tilla, të cilat mund të gjejnë zgjidhje vetëm nëpërmjet krijimit të një sistemi regjistrimi eficient dhe transparent të pasurive të paluajtshme. Vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet efektivisht e drejta e pronës së shtetasve (*shih vendimin nr. 6, datë 7.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8736, datë 24.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vitore Tusha, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo